



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## ZYRA E PROKURIMIT

Duke u bazuar në nenin 103/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Zyrtari përgjegjëse i prokurimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar nga Operatorët Ekonomik (OE): "EOR GROUP" SH.P.K dhe N.T.SH "RIKON"

Palëve të interesit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve digjitale për sallën e Kuvendit" me numër të prokurimit 615-20-5644-1-2-1 mori këtë:

### VENDIM

I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik: "EOR GROUP" SH.P.K dhe N.T.SH "RIKON" dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

II. **ANULOHET** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi i pajisjeve digjitale për sallën e Kuvendit" me numër të prokurimit 615-20-5644-1-2-1 dhe numër të brendshëm 61520113121 të inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës

### Arsyetim

Operatorët Ekonomik "EOR GROUP" SH.P.K dhe N.T.SH "RIKON" nga Prishtina me datën 16.11.2020 si palë të pakënaqura kanë bërë kërkesë për ri-shqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 11.11.2020 me të cilin është shpallur fitues OE "TRIO TEK SH.P.K dhe TETRONIKS LLC nga Prishtina me vlerë totale të ofertës 116,984.50 €.

Operatorët Ekonomik "EOR GROUP" SH.P.K dhe N.T.SH "RIKON" nga Prishtina me datën 16.11.2020 si palë të pakënaqura kanë bërë kërkesë për ri-shqyrtim me pretendimet se:

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar LPP-në pasi që nuk ka respektuar Nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së:

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca  
Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Kërkojmë nga Autoriteti kontraktues që të RI-SHQYRTOJË kërkesen tonë duke e respektuar LPP-në ,pasi që në bazë të kërkesave të Dosjes së tenderit ne i plotsojmë të gjitha kërkesat e dhëna me DT.

Pas kërkeses për çasje në dokumenta të drejtuar me 13.11.2020, Autoriteti Kontraktues na dhe mundesin e çasjes në dokumente dhe me 13.11.2020 shiquam dokumentet e Grupit të Operatorve Ekonomik TRIO TEK SHPK dhe TETRONIKS LLC Duke marr për baz se ne kemi ofruar me ofertën me të lirë dhe produktet e toni të ofruara janë të ngjajshme (ekuivalente) me ato të kërkuara me Aneksin 1 të DT-së dhe jemi me çmimin më të lirë, lusim Autoritetin Kontraktues ta rishqyrtoi edhe një here ofertën e dhënë nga Grupi i Operatorve Ekonomik: "EOR GROUP"

SH.P.K dhe N.T. SH. " Rikon ", kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues të anuloi vendimin paraprak Njoftim për vendimin e AK-së të datës 11.11.2020 dhe të shpallë Njoftimin e ri për dhënje ku Grupi i OE-ve eor group sh.p.k dhe N.T. SH. " Rikon ", shpallet fitues i tenderit, pasi që jemi OE e përgjegjeshme me çmimin më të lirë.

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka shkelur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës) dhe RRUOPP, dhe për deri sa Grupit të Operatorve Ekonomik TRIO TEK SHPK dhe TETRONIKS LLC ka produktet të cilat nuk i plotsojnë specifikimet teknike siç kërkohen me Aneksin 1 të DT-së dhe të ky grup i OE-ve pranohen produktet me karakteristika teknike me të dobëta se ato të kërkuara me Aneksin 1 të DT-së ndersa për Grupin e Operatorve Ekonomik eor group SHPK dhe NTSH Rikon nuk pranohen as një ndryshim prej specifikimit teknik. Këto ndryshime edhe pse nuk janë të njëjta me kërkesat e dhëna minimale të Aneksi 1 në DT nga Grupit të Operatorve Ekonomik TRIO TEK SHPK dhe TETRONIKS LLC ( Siç është rasti të POS 26 të monitori ku Autoriteti Kontraktues kërkon që Response Time të jetë 4 ms, ndersa Grupit të Operatorve Ekonomik TRIO TEK SHPK dhe TETRONIKS LLC kanë ofruar monitor me Response Time 5 ms dhe ky model të ky grup është pranuar, ndersa për të njëjten arsye modeli i monitorit të ofruar nga Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK dhe NTSH Rikon pse e kishte Response Time 5 ms nuk pranohet), AK-ja përdor standarde të dyfishta ndaj të njëjtit specifikim teknik, e që është në kundërshtim me kërkesat minimale të dhëna me Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe vetë LPP-në.

Kur themi se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform Neni 1- Qëllimi, Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca paragrafi 3 dhe paragrafi 6 (iii) dhe Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, është se:

Nga vendimi i Autoritetit Kontraktues, na bën të dyshojmë se më këtë rast është favorizuar një Operator Ekonomik apo Grup i Operatorve Ekonomik e që është në kundërshtim me LPP-në, pra po favorizohet një OE apo grup i OE-ve nga Autoriteti Kontraktues, pasi që Aneksi 1 i DT-së është tersisht në kundërshtim me Neni 1, Nenin 7 paragrafi 6(iii).

Autoriteti Kontraktues me ndihmen e Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka përdorur praktika për eliminimin e konkurrencës duke dhënë kritere dhe kërkesa si dhe specifikime teknike që e kanë favorizuar një operator ekonomik apo grup të operatorve ekonomik dhe kanë diskriminuar operatoret ekonomik të tjerë.

Kur themi këtë se është favorizuar një operator ekonomik apo grup i operatorve ekonomik, më poshtë po ju prezantojmë edhe faktet relevante, si në vijim:

Autoriteti Kontraktues në Aneksin 1 të dosjes së tenderit ka kërkuar produkte të caktuara dhe për këto produkte ka dhënë specifikime teknike me të gjitha të dhënat teknike detale 100% për produktin. Në treg nuk mund të gjindet asnjë produkt ku është 100% i njëjtë në mes vete po ka vetem produkte ekuivalente, pasi që produktet PATENTOHEN nga prodhuesi dhe nuk mund të kopjohen apo të prodhohen produkte identike 100% nga prodhues tjerë, mirpo janë produkte ekuivalente të cilat i plotsojnë përafërsisht ( 100%) të kërkesave e që duhet të jetë e pranueshme për Autoritetin Kontraktues, sepse në të kundërt, me anë të specifikimit teknik të prezantuar qëllimi i Autoritetit Kontraktues paska qenë të favorizohet ndonjë Operator Ekonomik apo Grupi i Operatorve Ekonomik, si në rastin tonë.

Nga faktet e paraqitura me lartë, dhe vendimi i datës 11.11.2020 na bënë për të dyshojmë se Grupi i Operatorve Ekonomik i shpallur fitues, nuk është në përputhje me LPP-në dhe vetë FTD ,Neni 6.

Përshtatshmëria e Operatorve Ekonomik, ku thuhet:

6.1 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i tij/saj:\.



a. ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues;

b. ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të këtyre të fundit; ose c. duke qenë në cilindo rast në një konflikt interesi, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1.75. Pasi që, nga Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 dhe Aneksi 1 i DT-së, japin arsye për të kuptuar se në përgatitjen e Aneksi 1 dhe Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të DT-së, kanë qenë pjesëmarrës edhe ndonjë punonjës/individ nga Operator Ekonomik apo Grupi i Operatorve Ekonomik që ju ka ofruar përshkrime teknike për produkte të caktuara, e që këto të dhëna janë shfrytëzuar nga Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes së Aneksi 1 dhe Dosjes së Tenderit.

Ky fakt lind duke marr për bazë specifikimet teknike të dhëna me Aneksin 1 të DT-së, këtë rast është specifikim teknik në detaje për secilin produkt 100%, ku është larguar vetëm emri i produktit dhe një herit për të mos ja u mundësuar me të njejtat produkte të konkurojnë edhe Operatorët Ekonomik tjerë duke e ditur faktin se dy produkte të njejtat 100% më përshkrimin teknik të njejt nuk ka, është kërkuar nga Operatorët Ekonomik të sjellin MAF-i për këto produkte, ku me ndihmen e specifikimit teknik dhe MAF-it Autoriteti Kontraktues i krijon favore një Operatori Ekonomik apo Grupit të Operatorve Ekonomik dhe ju pa mundësohet pjesëmarrja

Operatorve Ekonomik të tjerë me të njejtat produkte për të ofruar ofertë.

Kjo më së miri shihet me vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 11.11.2020, i cili vendim thirret në këto specifikime teknike, dhe qoftë edhe për ndryshime teknike minore të produkteve që nuk i plotsojnë kërkesat 100%, ka eliminuar Operatorët Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues zgjedhë të shpërblej Grupin e Operatorve Ekonomik TRIO TEK SHPK dhe TETRONIKS LLC, bazuar në faktet e sipër përmendura rrjedhë se është favorizuar ky grup i Operatorve Ekonomik dhe Autoriteti Kontraktues e dëmton buxhetin në vlerë prej: 19,672.50 €, duke e shpërblyer Grupin e Operatorve Ekonomik TRIO TEK SHPK dhe TETRONIKS LLC me çmim prej 116,984.50 € dhe e eliminon grupin e Operatorve Ekonomik EOR GROUP SHPK dhe NTSH RIKON me ofertën prej 97,312.00 € me produkte ekuivalente me ato të kërkuara me Aneksin 1 të DT-së, pra në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka favorizuar një Operator Ekonomik apo Grup të operatorve ekonomik dhe ka diskriminuar një operator ekonomik apo grup të operatorve ekonomik tjetër duke zbatuar standarde të dy fishta.

Prandaj duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura pretendimet e Operatorit Ekonomik "EOR GROUP" SH.P.K dhe N.T.SH "RIKON" nga Prishtina, konsiderohen si pjesërisht të bazuara dhe si e tillë vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura mund të parashtrojnë ankesë pranë OSHP-së. Ankesat pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Nr. 14-370/03-0070667/20  
Podujevë, 18 nënëtor 2020



Menaxheri i ZP  
Rasim Fejza